

PROCESVERBAL

TIPI I KONTRATËS – PROCEDURËN E HAPUR E THJESHTUAR

SHËRBIME

“MENAXHIMI FINANCIAR, TESTI I ZHVLERËSIMIT DHE IFRS9”

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “MENAXHIMI FINANCIAR, TESTI I ZHVLERËSIMIT DHE IFRS9”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbime të tjera - 98390000-3.

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,950,000 (dy milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a., ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetë deklaramit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në:

-Nenet 82 dhe 83 të LPP Nr. 162/2020, ku respektivisht theksohet:

“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”;

“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

-Nenet 26, dhe 30, pika 1, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP Nr. 162/2020, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke marrë në konsideratë specifikën e objektit procedurë prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë dokumentacionin ku të vërtetojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënljore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë llojin e shërbimeve objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate dhe në këtë mënyrë, AK ka mundësuar lejimin dhe pjesmarrje sa më të gjerë të shoqërive.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij mesatarisht 5 (pesë) punonjës për periudhën Mars 2024- Maj 2024.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, për të bërë të mundur kryerjen e këtij shërbimi specialistët si më poshtë:

- Drejtuesi i ekipit duhet të jetë kontabilist i çertifikuar kombëtar ose ndërkombëtar me eksperiencë në auditimin financiar.
- Jo më pak se 1(një) ekspert të menaxhimit financiar të çertifikuar si analist financiar kombëtar ose ndërkombëtar.
- Jo më pak se 1(një) ekspert kontabiliteti të çertifikuar kombëtar ose ndërkombëtar.
- Jo më pak se 1(një) vlerësues biznesi të çertifikuar nga shoqata vlerësuesish ose institucione ndërkombëtare.

Në lidhje me kriteret e mësipërme 2.3.2 dhe 2.3.3, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe më pas ofertuesi i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si:

- Kontrata e punës,
- Dëshmitë e kualifikimit (çertifikatë) të personelit të kualifikuar
- CV- të përkatëse, si dhe listë pagesat E-SIG 25 për periudhën Mars 2024- Maj 2024.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, pikës 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet, që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

Këto kritere janë vendosur në përputhje me termat e referencës, ku janë kërkuar 2 procese pune të ndara, ku për secilën prej tyre kërkohet minimalisht një ekspert i fushës, për të cilën po bëhet vlerësimi (pra minimalisht 2 ekspertë të çertifikuar) dhe për shkak të volumit të madh të punës kërkohen edhe specialistë të tjerë për përmbylljen brenda afateve të procesit.

Vlerësimi konsiston më së shumti në 2 pika:

- IFRS 9, që kërkon një grup të trajnuar shumë mirë dhe të jetë në korrent me të gjitha ndryshimet e fundit të standarteve, si dhe aplikimin e tyre në sektorin energjitik, me specifikat e një tregu të rregulluar si është në Shqipëri, si dhe ekspertë të kualifikuar dhe çertifikuar për të bërë këtë vlerësim.
- Zhvlerësimi i asetëve, i cili kërkon ekspertë me eksperiencë shumë të madhe, të licencuar në fushën e vlerësimit dhe që e njohin shumë mirë ecurinë e sektorit, me specifikat e një tregu të rregulluar si është në Shqipëri.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termet e referencës janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojën e Autoritetit Kontraktor për kryerjen e këtij shërbimi. Më specifikisht - Kryerja e testit të zhvlerësimit (Impairment Test) për Aktivet Afatgjata Materiale, bazuar në aftësinë e tyre për të gjeneruar flukse monetare, për qëllime të Raportimit Financiar,

në përputhje me SNRF-të. -Vlerësimi i huave të dhëna edhe të marra me vlerën e drejtë në momentin fillestar për huatë e reja, llogaritja e kostos së tyre të amortizuar si dhe llogaritja e vlerës së drejtë në momentin e paraqitjes në pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). -Konsulencë (analizim dhe implementim) për zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) aplikimi i të cilëve hyn në fuqi gjatë periudhës raportuese, që duhet reflektuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare si edhe aplikimi i SNRF 9.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Njësia e prokurimit